33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovimi.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/ose

b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

(a) Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

(b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;

(c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkitja;

(d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

(e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dënimeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|-----------|--|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë <i>gjuha shqipe</i> . |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% i vlerës totale të kontratës në afat prej 13 muajsh</i> . |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit. |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>12 muaj prej momentit të nënshkrimit të kontratës</i> |
| Regjistri i punës | 20.1 | Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA. |

| | | |
|--|------|--|
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: n/a |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së Illogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". |
| Shkaqet kompensim për | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj pas nënshkrimit të raportit-pranimit të punëve nga menagjeri i projektit. |
| Pagesa shkëputjes kontratës pas së | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | <i>[a] Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</i> <i>ose</i> <i>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</i> <i>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykatë apo arbitrim.</i> |

| RENOVIMI I SHFIMU "METO BAJRAKTARI" PRISHTINE | | | | | |
|--|---|---------|-------|-------------------|-------------------|
| Paramasa dhe parallogjaria | | | | | |
| PUNËT NDERTIMORE DHE ZEJTARE | | | | | |
| Kushte të përgjithëshme | | | | | |
| Përshkrimi i punëve. Në përputhshmeri të plote me standardet EC dhe ISO. | | | | | |
| Paramasat dhe parallogjaria është e dhënë detalisht në përshkrimin teknik, dhe i nënshtrohet përshkrimit teknik. | | | | | |
| <p>Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këto mënyre duhet të bëhet rrethimi sa më i mirë i punishtes dhe vendosjes e materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preveniva) hapsinore në mes të zonës nën ndërtim (RENOVIM) dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve. Materialet nuk duhet të dalin jashtë rrethojës së punishtes.</p> <p>Punishtja të rrethohet me tabela prej llamërine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në toke. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashoh edhe çkycjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikuqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.</p> | | | | | |
| Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO. | | | | | |
| Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurrjen në vepër të materialeve për secilin pozicion | | | | | |
| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi me TVSH (€) | Shuma me TVSH (€) |
| 1 | PUNIMET PËRGADITORE | | | | |
| 1.1 | Preventiva hapsinore në mes të zonës nën NDERTIM (renovim) dhe zonave tjera në afërsi. Sip. Sp. Teknik. Me preventive këtu nënkuptohet përgatitja e elaboratit të vendpunishtes, percaktimi i shkallës së rrezikut konform vendpunishtës dhe percaktimi dhe evendosja e sinjalistikës së rrethojës në vendpunishje dhe rreth vendpunishtes. | komplet | 1.00 | 100.00 | 100.00 € |
| 1.2 | Shkyqja e përkohëshme e instalimeve eksistuese (ujesjellesi, kanalizimi, ngorhja, ventilimi, rryma, IT dhe instalimet e ngjajshme), si dhe rikuqja e tyre pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe preventivi i konzervimit të instalimeve egzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas ndërtimit të objektit. Obligimin për njoftimin për çkycje dhe rikuqje ndaj kompanimeve rajonale të instalimeve në fjalë duhet ta marrë OE. Gjate çkycjes dhe rikuqjes duhet tu kushtohet rëndësi ndermarrjes korrekte të hapave të punës asisoj që të mos demtohet infrastruktura - në rast të demtimit/humbjes së infrastrukturës në cmin përshihen taksat/denimet dhe shuma e demtimeve deri në funksionalizimin korrekt të infrastrukturës konform gjendjes paraprake dhe gjendjes së parapare në projekt. VEREJTJE: Parapakisht nga AK duhet të bëhet evidentimi me shkrim i infrastrukturës që do të riparohet dhe asaj që nuk do të riparohet (të cilat do të çkycet dhe rikuqet) me rastin e përfundimit të punimit. | komplet | 1.00 | 50.00 | 50.00 € |



| | | | | | |
|---------|--|----------------|---------|-------|------------|
| 1.3 | <p>Formimi i kantierit te ndertimit. Vendosja dhe instalimi i hapësirave te perkoheshme per pune, siguri dhe shendet ne pune gjate orarit te punes gjate ekzekutimit te punimeve nga fillimi deri ne përfundimin e tyre. Kontraktori duhet te vendos ne një vend të përshtatshëm në vend-ndertim apo afërsi të vendit të ndërtimit, zyre të perkoheshme (së paku një Kontejner) për nevoja të operimit dhe organizimit të punës për inxhinierin e udhëheqjes së ndërtimit apo inxhinierëve të fazave të renovimit dhe ndërtimit si dhe për nevoja të mbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit të ndërtimit si dhe dhoma apo ndërtime të perkoheshme, zveshtore apo garderoba dhe durlarës dhe toaleta për nevoja të stafit dhe punëtorëve të kontraktorit gjatë orarit dhe tërë periudhës së ekzekutimit të punimeve të renovimit. VEREJTJE: OE ka obligim që të bëjë kycjen e perkohshme me njëhësore/ore-mates te perkohshem per plotesimin e nevojave te kantierit (elektrike, ujsejellesi, kanalizimi, IT, ngrohje, mbeturina dhe nevoja te tjera qe lindin gjate operimit ne kantier) pra lidhjen e kontenerit, zyreve dhe pjesve tjera percjellase te kantierit (banjot, zveshtoret dhe llavamnet) ne fjale me lidhje me njëhësor te perkohshem ku shpenzimet ne fjale barten ne llogari te OE. Konteneret/infrastruktura ne fjale janë paisje operative ne pronësi të kontraktorit për ekzekutimin e punimeve dhe të tilla mbesin edhe pas përfundimit të punimeve.</p> | m ² | 12.00 | 5.00 | 60.00 € |
| 1.4 | <p>Punimi i rjetit te perkohshem te instalimeve komunale per nevojat e punetorise dhe kantierit. Ketu perfishihet kontakimi nga ana e OE dhe aranzhimi i tij se bashku me kompanimeve rajonale ne fjale per kycjen dhe vendosjen e orematesve te perkohshem para fillimit te punimeve per furnizim me uji, mbeturinat, rryme si dhe vendosja e gjeneratorit dhe pompave te ujit shtese ne rast se infrastruktura e perkohshme nuk i perballion nevojat e punishtes dhe kantierit - si dhe kycjen dhe menjanimin e tyre pas përfundimit te punimeve. VEREJTJE: Shpenzimet, kostot e kycjes dhe kycjes se instalimeve te perkohshme dhe ato te shpenzimeve qe regjistrohen nga orematesit e perkohshem dhe tarifat tjera duhet te mbulohe nga ana e OE.</p> | komplet | 1.00 | 50.00 | 50.00 € |
| Shuma 1 | | | | | 260.00 € |
| 2 | PUNET E DEMOLIMIT DHE PASTRIMIT | | | | |
| 2.1 | <p>Demolimi, pastrimi i dyshemesë dhe pergaditja e pozicionit per punimin e shtresave te reja te objektit, pozicioni përfshinë dyshemet pllaka keramike, parket, laminat, teraceri, lenoleumi sipas projektit dhe largimi i mbeturinave deri ne deponine me te afert. Te gjitha dyshemet qe do te demolohe te llogariten me te gjitha shtresat deri ne pilaken e betonit duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit. Te pregatitet hapësira per vendosjen e dyshemes se re.</p> | m ² | 1581.61 | 1.90 | 3,005.06 € |
| 2.2 | <p>Gryerja e sipërfaqes së suvatimit deri blloka dhe shtresave tjera mbi suvatim në mure dhe tavane, pozicioni përfshinë edhe pastrimin e punishtës gjatë gjithë kohës së realizimit të këtijë aktiviteti si dhe largimi i mbeturinave deri ne deponine me te afert.</p> | m ² | 9763.51 | 0.10 | 976.35 € |
| 2.3 | <p>Demolimi i mureve ekzistuese të dëmtuar sipas projektit dhe largimi i mbeturinave deri ne deponine me te afert. Te gjitha muret qe do te demolohe te llogariten me te gjitha shtresat deri ne sipërfaqet e bllokut duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit. Te pregatitet hapësira per vendosjen e izolimit të ri. Muret duhet te demolohe me metoda të ndryshme varesisht kërkesave te AK: - me mjete dhe aparatura specifike (sharre për mure betoni dhe për ato me tulla) ne raste kur kerkohet prerja precize dhe ruajtja e pjeses tjeter te mureve nga dridhjet dhe plasaritjet - me mjete te thjeshta/klasike (çekan) ne raste kur kerkohet thjeshtia e menjamimi i këtyre mureve</p> | m ² | 840.00 | 1.00 | 840.00 € |



| | | | | | |
|--|--|----------------|--------|---------|------------|
| 2.4 | Demolimi i pllaka keramikës, suvatimit, izolimit në muri sipas projektit dhe largimi i mbeturinave deri në deponinë me të afert. Te gjitha muret që do të demoloohen të llogariten me të gjitha shtresat deri në sipërfaqet e bllokut duke përfshirë edhe gypat e ujit dhe kanalizimit. Te përgatitet hapësira për vendosjen e izolimit të ri. | m ² | 457.00 | 3.00 | 1,371.00 € |
| 2.5 | De-montimi i elementeve të banjave në kate - në pozicion përfshihet heqja e të gjitha elementeve të cilat gjenden në hapsirat e banjave. Me elemente të banjave nenkuptohen: llavamanët, guacat, panelet ndarese të banjave, dyert ekzistuese të banjave, venetilat, bojleret, mbajtëset e pallomave, letrave të tualetit, tharesve të duarve, ankerat e panevojshëm etj. Elementet e de-montuara sipas gjendjes së tyre dhe kërkesës së AK mund të: -demoloohen dhe të dërgohen deri në deponinë me të afert -te de-montohen dhe të deponohen dhe izolohen në vende që përcaktohen nga AK. Te njëjtat mund të perdoren/montohen në banjot ekzistuese në skemën e mëhershme apo duhet të montohen në pjeset dhe skemat që përcaktohen nga AK apo projekti | copë | 34.00 | 25.00 | 850.00 € |
| 2.6 | Çmontimi i instalimit elektrik duke përfshirë edhe ndriqesit, në pozicion përfshihet heqja e të gjitha elementeve të cilat gjenden në hapsirat e banjave. Largimi dhe deponimi i këtyre elementeve të cilat janë në gjendje të mirë të përcaktohet nga personi zyrtar, ndërsa elementet e panevojshme të dërgohen në deponinë me të afert. Llogaritja për m ² të tavanit | m ² | 86.00 | 9.00 | 774.00 € |
| 2.7 | Çmontimi dhe dërgimi në deponi i dyerve të objektit. Te gjitha materialet të largohen deri në deponinë me të afert. VEREJTJE: Te çmontohen me kujdes pa u demtuar hapjen e derës dhe vet derën dhe (ri)vendosja e tyre nëse përcaktohet nga AK | | | | |
| | Dimensionet e dyerve | | | | |
| | 80/200 | copë | 8.00 | 5.00 | 40.00 € |
| | 90/210 | copë | 44.00 | 5.00 | 220.00 € |
| 2.8 | Demolimi i pllakës beton armë mbi themele me dimensione (30 x 30) cm për krijimin e hapësirës për montimin e gypit të kanalizimit si dhe gypit të ujit për qasje të puseta lidhëse me rrjetin e qytetit. Shpimi i vrimes duhet të bëhet me paisje/aparaturë speciale (me diamant) për prejren dhe hapjen e vrinave në material të beton-armesë që bëjnë hapjen e pastër të vrimes. VEREJTJE: Në çmim parashihet edhe largimi i mbeturinave dhe pluhurit në deponinë me të afert, si dhe sanimi në rast se ndodhin çarje apo dëmtime shtesë të pllakës gjatë hapjes së vrimes. | m ² | 20.00 | 5.00 | 100.00 € |
| 2.9 | Demolimi i anesoreve të drurit neper klase. Demolimi duhet të bëhet me kujdes ashtuqë të krijohet sa më pak dem gjatë demolimit të tyre. Te gjitha materialet të largohen deri në deponinë me të afert. VEREJTJE: Në çmim parashihet edhe largimi i mbeturinave dhe pluhurit, si dhe sanimi në rast se ndodhin çarje apo dëmtime shtesë të pllakës gjatë hapjes së vrimes. | m ² | 875.00 | 0.20 | 175.00 € |
| | | | | Shuma 2 | 8,351.41 € |
| 3 | PUNET E SUVATIMIT DHE MURATIMIT | | | | |
| Sipërfaqja është e kalkuluar bruto përfshirë shpaletat, këndoret e nevojshme nga prodhuesi, fugal e dilatimit për fasadë, këndoret me ngjites nga PVC rreth dritareve - hapjeve. Hapjet zbriten nëse janë me të mëdha se 2m ² (vetëm hapjet deri në 2m ² llogariten në sipërfaqe bruto). Në këto pozicione përfshihen edhe të gjitha materialet përcjellëse të nevojshme për realizimin e aktiviteteve | | | | | |



Punimi i pozicionit te recepsionit sipas detalit te dhene nga AK. Ne cmim duhet te parashihet furnizimi, transporti, punimi dhe montimi i ketyre njesive te ketij pozicioni:

- Tavolina e recepsionit: Pjesa e jashtme/mveshja e tavolines. Materiali MDF i bardhe i ngjyrosur me gjysemshkelqim me $t=1\text{cm}$, me lidhje me minifiksa me ISO standarde (bulona te fshehur). Tavolina duhet te kete edhe pjesen e sirtareve me tre sirtar me hapje pneumatike te bendit "Blum" apo ekuivalent.

Pjesa e brendshme nga iverplaka me ngjyre te bardhe me $t=1\text{cm}$. Tavolina duhet te kete zgavrrat rumbulike me $d\approx 4\text{cm}$ per endjen diskrete te kablove

- Pjesa e dyshemese e percaktuar ne detal, duhet te ekzekutohet me folie/ceradë te plastifikuar ngjyre te bardhe qe nuk shqyhet apo demtohet me kohe. Folia duhet te jete me gjysemshkelqim, dhe te kete ngjitesin e saj me fortesi te madhe qe nuk lejon shkeputjen e folies nga loka per shkak te ferkimit dhe te mos demtohet nga kemikatet dhe procesi i pastrimit.

- Ekzekutimi i paravaneve nga grid e çelikut me modul te gridit $3\times 3\text{cm}$, me trashesi te profilit $t=2\text{mm}$ dhe gjeresi te profilit $\delta=2\text{cm}$. Ngjyra me te cilen do te duhet te lyhen keto paravane eshte ngjyre metalike me ngjyre te bardhe. Ne cmim duhet te parashihet edhe konstruksioni shtangues dhe ankerimi i ketij pozicioni per mure dhe dysheme.

- Ekzekutimi i elementit te pllafonit dhe shtangimi i tij per pllafon. Elementi duhet te jete nga material panel "Fundermax" apo ekuivalent me trashesi $t=1\text{cm}$. Te realizohet me konstruksion metalik diskret me ankerime diskrete. Ngjyra e panelit duhet te jete sipas detalit te dhene.

- Drite LED me trup nga materiali i legura e aluminit me trashesi $t=3\text{mm}$, me dimenzione $240\times 7-10\text{cm}$, me keto karakterisitke:

-90lm/e,

-3000lm,

-me temperature 3000K-3200K,


-Flicker Free

-IP 65.

Drite "Philips" apo ekuivalent. Drita duhet te kete konstruksionin e saj te aluminit te lyer me ngjyre te bardhe, kordon te rrymes te bardhe dhe aksesoret percjelles dhe te gjitha pjeset fazonike. Kablot tjera pos kablove standarde te drites duhet te fshehn ne pllafon dhe te jene diskrete.

- Drita LED 2 copa,

-pllafonier 60x60,



-3500K

-Trupi i drites duhet te jete nga alumini apo plastika e forte qe nuk demtohet, me ngjyre te bardhe.

VEREJTJE:

Ne cmim duhet parashihen te gjitha elementet lidhese, pjeset fazonike per ekzekutimin dhe funksionalizimin (lidhjen me rryme, internet dhe IT) e plate te ketij pozicioni sipas detalit dhe skicave te dhena nga AK.



3.1

cope

1.00

900.00€

900.00 €



| | | | | | |
|-----|--|----|--------|---------|------------|
| 3.2 | <p>Furnizimi dhe montimi i anesoreve te klaseve per mbrojtjen e murit nga materiali i MDF i ngjyrosur me shkelqim mesatar, me dimenzione h=20cm, pergjate 2/4 t perimetrit te klaseve.</p> <p>Instalimi i MDF pllakave ne mure duhet te behet me bulona me tipla ~3cm dhe me silikon te forte. Bulonat duhet te fshehen me material te ngjajshem me teksturen MDF</p> <p>Materialet e perdorura duhet te jene jo toksike, VOC nen 1.0gr/L.</p> <p>Ngjyra e MDF perzgjidhet nga AK</p> <p>Keto elemente duhet te vendosen ne lartesi h=80cm (dimenzionet te merren edhe njehere ne vend, konform lartesis se inventarit te shkolles karrigave dhe bankave)</p> | m' | 875.00 | 3.40 € | 2.975.00 € |
| 3.3 | <p>Furnizimi dhe montimi i varesve te rrobave neper klase nga materiali i MDF i ngjyrosur me shkelqim mesatar, me dimenzione l=200cm dhe h=20cm</p> <p>Instalimi i MDF pllakave ne mure duhet te behet me bulona me tipla ~3cm dhe me silikon te forte. Bulonat duhet te fshehen duke u mbushur me tape apo material te ngjajshem me teksturen e MDF.</p> <p>Materialet e perdorura duhet te jene jo toksike, VOC nen 1.0gr/L.</p> <p>Ngjyra e MDF perzgjidhet nga AK</p> <p>Ne cmim duhen te parashihen edhe vareset e rrobave dhe fiksimi i tyre me tipla ku ngjyra, materiali dhe dizajni i te cilave perzgjidhet nga AK.</p> <p>Keto elemente duhet te vendosen sipas detalit te dhene nga AK (dimenzionet te merren edhe njehere ne vend, konform lartesis se inventarit te shkolles karrigave dhe bankave)</p> | m' | 140.00 | 10.00 € | 1.400.00 € |




Furnizimi me material si dhe montimi i rruëve ndarëse për toaleta dhe dusheve me HPL panela (High pressure laminate) me trashësi 10mm sipas standardeve evropiane të rezistueshme ndaj lagështisë, të përshatshme për hapësira të lagështa (nyje sanitare-banjo). Ngjyra dhe tekstura e paneleve mund të variojë nga ato me të hapurat (zbehtat) deri tek ato me pigment të lartë (ngjyrat vivide), si dhe ato me strukture/teksture druri apo të ngjajshme.

Në çmim duhet të përfshihen edhe konstruktimi i dyerve sipas detaleve të dhëna me projekt, dhe të gjitha elementet e nevojshme siq janë mbajtëset, konstruksioni metalik, ankerat për mure, mënteshat, dorëzat për dyer, celsat (hapje/mbyllje), mbajtëset me bazament - të gjitha këto me material jo korodues metal inox. Poashtu konstruksioni dhe lidhjet e HPL paneleve të banjove duhet të jenë të tipit diskret dhe të ekuikutohen në mënyrë sa më diskrete (të fshehur) dhe fine dhe në të njëjtën kohë të jenë funksionale dhe statikisht të qëndrueshme për përdorim të shpeshtë.

VEREJTJE: Gjatë fazës së ofertimit në tender ofertuesi është i obliguar të sjellë Fletën Teknike të Materialeve dhe atestet deri në pranimin e mostrës nga ana e AK, si dhe të bashkangjës edhe katalogun për produktin e përshkruar në këtë pozicion. Të realizohet sipas detalit të dhënë nga AK.

Të bashkangjitet dokumentacioni autentik i prodhuesit si: Katalogë/pjesë të katalogut nga prodhuesi dhe/apo vizatim të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrim teknik detal për artikujt e ofertuar. Në Katalogë/pjesë të katalogut nga prodhuesi dhe/apo vizatim sipas specifikimeve teknike të kërkuara të nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.

3.4



m²

200.00

125.00 €

25,000.00 €



| | | | | | |
|------|--|----------------|----------|------|-------------|
| 3.8 | <p>Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e mureve, te brendshme, kthine mbi bazament të gletuar. Me ngjyre ekologjike ne dy shtresa me nuance të bardhë. Specifikat e ngjyres:</p> <p>Ngjyrë Klasike e bardhë (Polikollor).</p> <p>Ngjyrë me emulsion per perdorim te brendshëm për mbrojtje dhe dekorime te siperfaqëve.</p> <p>Aplikimi: me brushë/cilinder (valak), si dhe me makinë me sperkatje. Harxhimi: max 80-100m²/15L;</p> <p>Permbajtja e VOC <2g/l;</p> <p>Paketimi: 10-15L/kove.</p> <p>Rezistenca ndaj ferkimeve: 2000 ferkime (Ekuivalent me Jupol Classic)</p> <p>VEREJTJE:</p> <p>Ne cmim duhet te parashihet izolimi i hapësires me material izolues kualitativ per ruajtjen maksimale te kthines qe do te lyhet, shiritat izolues, si dhe tere paisjet tjera per funksioanlizmimin e pozicionit. Poashtu ketu perfshihet largimi i materialit izolues, shiritave dhe mbeturinave tjera qe gjenerohen gjate ekzekutimit te ketij pozicioni, si dhe pastrimin e vazhdueshem dhe total te kthines se ngjyrosur.</p> | m ² | 7,113.47 | 1.60 | 11,381.55 € |
| 3.9 | <p>Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e pllafonit mbi bazament të gletuar. Me ngjyre ekologjike ne dy shtresa me nuance të bardhë. Specifikat e ngjyres:</p> <p>Ngjyrë Klasike e bardhë (Polikollor).</p> <p>Ngjyrë me emulsion per perdorim te brendshëm për mbrojtje dhe dekorime te siperfaqëve.</p> <p>Aplikimi: me brushë/cilinder (valak), si dhe me makinë me sperkatje. Harxhimi: max 80-100m²/15L;</p> <p>Permbajtja e VOC <2g/l;</p> <p>Paketimi: 10-15L/kove.</p> <p>Rezistenca ndaj ferkimeve: 2000 ferkime (Ekuivalent me Jupol Classic)</p> <p>VEREJTJE:</p> <p>Ne cmim duhet te parashihet izolimi i hapësires me material izolues kualitativ per ruajtjen maksimale te kthines qe do te lyhet, shiritat izolues, si dhe tere paisjet tjera per funksioanlizmimin e pozicionit. Poashtu ketu perfshihet largimi i materialit izolues, shiritave dhe mbeturinave tjera qe gjenerohen gjate ekzekutimit te ketij pozicioni, si dhe pastrimin e vazhdueshem dhe total te kthines se ngjyrosur.</p> | m ² | 2,859.89 | 1.35 | 3,860.85 € |
| 3.10 | <p>Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e mureve, pllafonit te banjove, instalimeve qe gjenden nen pllafon dhe tek hyrja e banjove, ngjyra e te ciles perzgjidhet nga AK (ngjyra vivide me pigment te larte). Specifikat e ngjyres:</p> <p>Ngjyrë me emulsion per perdorim te brendshëm për mbrojtje dhe dekorime te siperfaqëve.</p> <p>Aplikimi: me brushë/cilinder (valak), si dhe me makinë me sperkatje. Harxhimi: max 80-100m²/15L;</p> <p>Permbajtja e VOC <2g/l;</p> <p>Paketimi: 10-15L/kove.</p> <p>Rezistenca ndaj ferkimeve: 2000 ferkime (Ekuivalent me Jupol Classic)</p> <p>VEREJTJE:</p> <p>Ne cmim duhet te parashihet izolimi i hapësires me material izolues kualitativ per ruajtjen maksimale te kthines qe do te lyhet, shiritat izolues, si dhe tere paisjet tjera per funksioanlizmimin e pozicionit. Poashtu ketu perfshihet largimi i materialit izolues, shiritave dhe mbeturinave tjera qe gjenerohen gjate ekzekutimit te ketij pozicioni, si dhe pastrimin e vazhdueshem dhe total te kthines se ngjyrosur.</p> | m ² | 437.50 | 3.00 | 1,312.50 € |



| | | | | | |
|------|---|----------------|----------|--------|------------|
| 3.11 | <p>Furnizimi dhe ngjyrosja e mureve me baze dhe ngjyrë yndyrore të klasit të parë sipas ISO. Lartësia e leryjes së mureve duhet të jetë $h=1.80m$ prej dyshemese së kthines. Kthinat duhet të ngjyrosen një here me baze të ngjyres/primer (me ISO, EN dhe CE standarde) si dhe me dy shtresa ngjyre, me mundësi +1 dorë ngjyre shtese, në zonat ku muri nuk ka marrë ngjyre si duhet. Muri duhet të ngjyrosset në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa vazhda.</p> <p>Ngjyra duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj ferkimeve me koeficient min.2000 ferkime. E njëjta duhet të ketë garancion që tregon se ka performancë të lartë ndaj parandalimit të krijimit të lagështisë/kondezit, kundër shfaqjes së mykut dhe kundër shumimit të bakterieve gjegjësisht të jete antibakteriale dhe bioaktive, të jete ngjyre që lejon frymim (breathable), me nivel të VOC partikulave nën $1.0gr/L$ - të gjitha këto karakteristika duhet të mbesheten dhe garantohen nga OE dhe prodhuesi përmes vulave/garancionit ISO, EN dhe CE standarde.</p> <p>Dukja-gjëndja: E lëngshme; Optika: me shkelqim; Nuancat e ngjyrave përcaktohen nga AK.</p> <p>VEREJTJE: Në cmim duhet të parashihet izolimi i hapësirës me material izolues kualitativ për ruajtjen maksimale të kthines që do të lyhet, shiritat izolues dhe shenjues për krijimin e vijës/lartësie apo horizontot $h=1.80m$, si dhe tere paisjet tjera për funksioanlizimin e pozicionit. Poashtu këtu përfshihet largimi i materialit izolues, shiritave dhe mbeturinave tjera që gjenerohen gjatë ekzekutimit të këtij pozicioni, si dhe pastrimin e vazhdueshëm dhe total të kthines së ngjyrosur.</p> | m ² | 2,650.04 | 2.60 € | 6,090.10 € |
| 3.12 | <p>Furnizimi me material si dhe ngjyrosja e mureve me baze/primer dhe me ngjyrë gjysem-yndyrore/gjysem-shkelqyese që ka rezistencë të lartë ndaj lagështisë, për kthinat me lagështi të lartë sic janë: nyjet sanitare/banjot, zhveshtoret, kuzhinat dhe kthinat e njajshme ku ka prezencë të lartë të lagështisë dhe avullit. Kthinat duhet të ngjyrosen një here me baze të ngjyres/primer (me ISO, EN dhe CE standarde) si dhe me dy shtresa ngjyre, me mundësi +1 dorë ngjyre shtese, në zonat ku muri nuk ka marrë ngjyre si duhet. Muri duhet të ngjyrosset në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa vazhda.</p> <p>Ngjyra duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj ferkimeve me koeficient min.2000 ferkime. E njëjta duhet të ketë garancion që tregon se ka performancë të lartë ndaj parandalimit të krijimit të lagështisë/kondezit, kundër shfaqjes së mykut dhe kundër shumimit të bakterieve gjegjësisht të jete antibakteriale dhe bioaktive, të jete ngjyre që lejon frymim (breathable), dhe të ketë nivel të koeficient të VOC partikulave nën 2.0 - të gjitha këto karakteristika duhet të mbesheten dhe garantohen nga OE dhe prodhuesi përmes vulave/garancionit ISO, EN dhe CE standarde.</p> <p>VEREJTJE: Në cmim duhet të parashihet izolimi i hapësirës me material izolues kualitativ për ruajtjen maksimale të kthines që do të lyhet, shiritat izolues dhe shenjues, si dhe tere paisjet tjera për funksioanlizimin e pozicionit. Poashtu këtu përfshihet largimi i materialit izolues, shiritave dhe mbeturinave tjera që gjenerohen gjatë ekzekutimit të këtij pozicioni, si dhe pastrimin e vazhdueshëm dhe total të kthines së ngjyrosur.</p> | m ² | 250.00 | 4.00 | 1,000.00 € |



| | | | | | |
|----------------|---|----------------|--------|------|--------------------|
| 3.13 | <p>Furnizimi dhe lyerja e radiatorave dhe gypave me ngjyre te bardhe dhe kaliter (RAL e se ciles percaktohet nga AK) per radiatora. Ne cmim duhet t'eparashihet edhe geryerja e radiatorëve te cilet te korroduar deri sa te rrafshohen dhe hiqen pjeset qe jane korroduara. Specifikat e ngyhres per radiatorë. Rezistente ndaj nxehtesise deri ne 80 grade celsius; Produkti ti plotesoj standardet EN 71-3 dhe EN 71-9</p> <p>VEREJTJE: Ne cmim duhet te parashihen te gjitha mjetet dhe substancat tjera (tretes) per funksionalizimin e pozicionet. Poashtu ketu parashihet edhe izolimi i hapësirës ku do te lyhen radiatorët - si dhe pastrimi final dhe largimi i mbeturinave te krijuara gjate realizmit te ketij pozicioni</p> | liter | 150.00 | 4.00 | 600.00 € |
| Shuma 3 | | | | | 68,910.73 € |
| 4 | PUNET E HIDROIZOLIMIT | | | | |
| 4.1 | <p>Furnizimi, transporti me material dhe hidroizolimi i dyshemeve dhe mureve deri ne lartësinë 90 cm nga dyshemeja të toaletesve, banjove dhe garderobave të punuara në hollët dhe koridoret e etazhave të objektit. Izolimi i dyshemeve me ARDULAN 8+9 (2 HERË) ose ekuivalent.</p> | m ² | 196.00 | 2.00 | 392.00 € |
| Shuma 4 | | | | | 392.00 € |
| 5 | PUNET E DYSHEMESE DHE PLAFONIT | | | | |
| 5.1 | <p>Furnizimi me material dhe shtruarja e estrih betonit me trashësi 5.5cm me tolerance te devijimit +/-10mm, me armature rrethë Ø4/15 cm dhe PV Folie. Klasa e estrihut duhet te jete C 20/25 i pasuruar me fibra. Fortesia/rezistenca e estrihut pas 28 dite te arrijtes se soleditetit duhet te jete 20,000kN/m2 apo 2.04kg/mm2.</p> <p>VEREJTJE: Estrih betoni duhet ta mbrrije fortesine e nevojshme). Lageshtia para shtrirjes se duhet të jetë < 4%.</p> | m ² | 437.50 | 5.20 | 2,275.00 € |
| 5.2 | <p>Furnizimi me material dhe shtruarja e shtreses vetenivelizuese nga baza e çimentos me fortesin e nevojshme per sanimin e siperfaqeve te demtuara dhe te paniveluara . Lageshtia e esitrihut para shtrirjes se dyshemesë duhet të jetë < 4%.</p> <p>VEREJTJE: Ne cmim duhet te parashihet edhe lyerja paraprake me TEC Primer per shumeqellime. TEC Primer duhet te jete me ISO, EN dhe CE standarde ku me theks te vecant duhet te kete sasi te VOC partikulave sa me te ulet (konform standardeve si me larte)</p> | m ² | 437.50 | 2.00 | 875.00 € |
| 5.3 | <p>Furnizimi me material si dhe punimi i shtresës së dyshemes me styropor, d=40mm (20mm+20mm) - XPS. Karakteristikat teknike te styroporit per dysheme jane: Pesha specifike: 26kg/m3. Rezistenca ne shtypje: 150kpa. Koeficioneti i perqeshmerise se nxehtesise: 0.024W/mK Ne pozicion te perfshihet edhe folia e PVC si dhe shiriti ndares ne mes murit dhe dyshemes.</p> | m ² | 437.50 | 2.00 | 875.00 € |



